



REPUBLICA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

Nr. 2825 / Prot. 3

Vlorë më, 05.12.2024

VENDIM

Nr. 88, datë 04.12.2024
PËR

**ÇELJEN E PROCEDURËS PËR VETËKANDIDIM PËR ANËTAR PËRFAQËSUES I
STUDENTËVE NË KËSHILLIN E ETIKËS (KE) NË UNIVERSITETIN "ISMAIL
QEMALI", VLORË**

Në mbështetje të nenit 44 të ligjit Nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 28, pika 2, të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, nenit 18 të Rregullores së UV-së, referuar shkresës nr.2139, prot, datë, 01.10.2024, Senati Akademik në mbledhjen e tij të radhës, datë 04.12.2024,

VENDOSI:

1. Të miratojë çeljen e procedurës për vetëkandidim për anëtar përfaqësues i studentëve në Këshillin e Etikës (KE).
2. Vetëkandidimet dorëzohen në Zyrën e Protokollit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë dhe do të administrohen nga sekretaria e Senatit Akademik.
3. Kjo periudhë do të zgjasë prej datës 04.12.2024 deri më datë 11.12.2024.
4. Ngarkohet Drejtoria e Komunikimit dhe Burimeve Njerëzore për shpallje në faqen Eëb të vendimit dhe bërjen e njoftimeve përkatëse.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Aurela Saliaj

